

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Minir Hoti, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Fatmire Podvorica, duke vendosur në lëndën penale të akuzuarit A. A. S. nga fshati Ll., Komuna e P., për shkak të veprës penale Vjedhje nga neni 325 par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.II.nr.6116/2014 të dt.26.08.2014, në seancën e shqyrtimit gjyqësor, të mbajtur në prezencën e Prokurorit të shtetit Basri Morina nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, dhe të pandehurit A.S., pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më dt.12.01.2015, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **A. S.**, nga i ati A. dhe e ëma F., e vajzërisë B., i lindur me *data e lindjes...* në fshatin Ll., Komuna e P., ku edhe tani jeton, i pa punë, i martuar baba i 2 fëmijëve, ka të kryer Fakultetin Juridik, i gjendjes së dobët ekonomike, nr. personal 2030829827, Shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosovës.

Në kuptim të nenit 364 par.1 pika 1.3 të KPPRK-së

L I R O H E T N G A A K U Z A

Sepse:

Më dt.06.08.2014, rreth orës 21:30, në rr. “Bedri Bajrami” në Podujevë i pandehuri A. S., me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme vetit ti sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm kishte dërguar me automjetin e tij të tipit “Audi 80”, ngjyrë hiri, nga Xhamia e Llapit për në Podujevë të dëmtuarin G. V. i cili kishte pasur me vete një valixhe me gjësende personale dhurata me vlerë prej 400 € si dhe një kamerë digjitale në vlerë prej 500€ të cilat arrinin shumën gjithsej rreth 900 €, dhe me të arritur në Podujevë afër shkollës “I. B.” i dëmtuari kishte zbritur nga automjeti dhe iu kishte drejtuar të pandehurit që të ndal; automjetin dhe të marrë valixhen nga bagazhi i automjetit, në atë moment i pandehuri kishte ikur në drejtim të panjohur duke i marr edhe valixhen në bagazh,-

- Me këtë kishte për të kryer veprën penale Vjedhje nga neni 325 par.1 të KPRK-së.

- për shkak se nuk është provuar që i akuzuari të ketë kryer këtë vepër penale.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

I dëmtuari G.V. nga Podujeva, rr.”....” pnr., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën PP.II.nr.6116/2014 të dt.26.08.2014, ka akuzuar A. A. S. nga fshati Ll., Komuna e P., për shkak të veprës penale Vjedhje nga neni 325 par.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale kjo gjykatë ka treguar shqyrtimin kryesor gjyqësor më dt.12.01.2015, në të cilën u dëgjuan Prokurori i shtetit Basri Morina nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, dhe i pandehuri A. S..

Prokurori i shtetit Basri Morina nga Prokuroria Themelore në Prishtinë ka përfaqësuar aktakuzën dhe sikurse gjatë shqyrtimit kryesor po ashtu edhe në fjalën e tij përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë aktakuzës PP.nr.II.6216/2014 të dt.26.08.2014, meqë e njëjta është e bazuar ne ligj, dhe se i akuzuari kësaj gjykate nuk ka arritur t’ia ofroj asnjë provë të vetme të mundshme dhe relevante ne bazë të se cilës gjykata do të vepronte ndryshe. Prandaj siç u tha sot ne shqyrtimin e sotëm i akuzuari, përpos fjalëve boshe nuk ka arritur ta argumentoj se ku ka qene me 06.08.2014, prej orës 20-30 deri ne ora 21,30, ndërsa dëshmitari B. L. nuk mund t’ia fali besimin, meqë nuk përket me realitetin objektiv sepse i njëjti ne deklarimet e tij është jo konciz po paraqet mjegulli dhe aspak nuk kontribuon ne ndriçimin e kësaj çështje juridiko-penale, ndërsa i propozoi gjykatës që të dëmtuarit t’ia fali besimin me që i është shkaktuar dëmi si ne shkresat e lëndës dhe krejt në fund i propozoi gjykatës së nderuar pasi që të bëjë shtjellimin e të gjitha provave të lëndës pasi që ti analizoj ato, konform dispozitave ligjore pozitive të aplikueshme ne territorin e Republikës së Kosovës të njëjtin ta shpalli fajtor dhe të dënoj sipas ligjit.

I akuzuari A. S. në mbrojtjen e tij gjatë shqyrtimit gjyqësor, ka theksuar se është i pa fajshëm dhe se e kundërshton në tërësi aktakuzën, duke deklaruar se ditën kritike, ne atë kohë kam qenë ne “E.” ne Fushë Kosovë, dhe jo vetëm këtë ditë por për çdo ditë ne sezonin veror, sepse i transportoj disa punëtor të E.-së. Nuk mbaj ditari pune mirëpo çdo ditë ne atë kohe kam punuar ne atë relacion prej E.. Atë ditë B. L. i ka pasur datëlindjen e një familjari të tij, dhe ai me ka ftuar për një kafe ne E., dhe prej orës 21:30 deri ne ora 22,10 minuta kam qëndruar aty. Dëshmitarin B. L. e njoh vetëm si taksist që 1 vite e gjysmë, pasi që jam larguar nga puna. Nuk e njoh fare G. V. vetëm babain e tij T. V. me te cilin kam punuar polici ne Podujevë, me të cilin kam pasur raporte shume të këqija, për arsye sepse unë para luftës ne Kosovë kam punuar ne Kuvendin Komunal te Podujevës ne kohën kur gjithë shqiptaret janë larguar nga puna me dhunë. Ditën kritike prej orës 20,30deri ne ora 21,30, kam transportuar udhëtar me veturën time prej Fushë Kosovës te Grandi, Tre sheshirat dhe Fushë Kosovë. Unë ne bagazh e kam bocën e plinit dhe bagazhi i veturës Audi është shume i vogël edhe gjithçka çka kanë udhëtarët i marrin brenda veturës. Ditën kritike në orën kritike prej orës 20-30, e deri ne ora 21, 30, nuk kam qenë fare të Gjamia e Llapit, sepse nuk e kam atë relacion dhe nuk kam bartur udhëtar për ne

Podujevë pasi unë e ndije veten të frikësuar për të bartur udhëtar për ne Podujevë, pasi që unë kam punuar atëherë kur të gjithë shqiptarët janë larguar nga puna.

Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se unë në çdo ftese të gjykatës jam paraqitur dhe kërkoj nga kjo gjykatë që vetëm të zbatohet ligjin, ngase i dëmtuari-dëshmitari edhe pse është ftuar në mënyrë të rregullt asnjëherë nuk është paraqitur në gjykatë, andaj i kërkoj gjykatës që të marr aktgjykim lirues meqenëse me asnjë prove nuk është vërtetuar se kam kryer veprën penale.

Gjykata ka administruar provat e propozuar: dëgjimin e dëshmitarit B. L., njoftimin mbi veprimet e policisë për bastisje të shtëpisë dhe objekteve përcjellëse të dt.26.08.2014, ndërsa sa i përket propozimit për dëgjimin e të dëmtuarit-dëshmitarit G. V., gjykata duke u bazuar në neni 258 par.1 dhe 2 nën par.2.3 të KPPRK-së, e ndaloj marrjen e provës pasi që i njëjti sipas informatës së Policisë së Kosovës Stacioni Policor në Podujevë të dt.13.11.2014, gjendet në shtetin e I. dhe nuk ka kurrfarë mundësie për tu paraqitur në shqyrtimin gjyqësor, pasi marrja e kësaj prove është e pa arritshme.

Gjykata pas procedurës së provave, vlerësimit të provave të administruara një nga një e të gjitha së bashku në lidhmëri në mes tyre gjeti këtë gjendjen faktike:

Se nuk është provuar se i akuzuari A. S. ka kryer veprën penale Vjedhje nga neni 325 par.1 të KPRK-së, për të cilën akuzohet. Me provat e administruara pa dyshim është vërtetuar se vjedhja nuk është kryer nga ana e të akuzuarit.

Deri te kjo gjendje faktike gjykata erdhi duke u mbështetur në mbrojtjen e të akuzuarit A. S. i cili gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor e ka mohuar akuzën dhe kryerjen e veprës penale, deponimet e dëshmitarit të mbrojtjes B. L. si dhe nga njoftimi mbi veprimet e policisë për bastisje të shtëpisë dhe objekteve përcjellëse të dt.26.08.2014.

Nga dëshmia e dëshmitarit B. L. i cili në shqyrtimin gjyqësor në dëshminë e dhënë ndër të tjera ka deklaruar se me datën 06.08.2014, prej orës 21:00, kam qëndruar me A. në E. rreth një orë dhe pastaj kam shkuar në shtëpi, ndërsa A. ka vazhduar të qëndroj aty edhe më tutje, u vërtetua mbrojtja e të akuzuarit A. S. se ditën kritike dhe kohën kritike ka qenë Fushë Kosovë në E..

Nga njoftimi mbi veprimet e policisë për bastisje të shtëpisë dhe objekteve përcjellëse të dyshuarit A.S. i dt.26.08.2014, u vërtetua fakti se nuk janë gjendur në posedim të akuzuarit sendet e kërkuara të raportuara si të vjedhura.

Gjykata ia ka dhënë besimin e plotë deklaratës së dëshmitarit B. L., ku shprehimisht thotë se ai ka qenë prezent me të akuzuarin në E. në Fushë Kosovë më dt.06.08.2014 prej orës 21:00 rreth një orë.

Gjykata ia ka dhënë besimin e plotë deklaratës se të pandehurit sepse i njëjti me deklaratën e dhënë ka vërtetuar se ditën kritike dhe orën kritike ka qenë në Fushë Kosovës në E., andaj në një gjendje të tillë nuk ka mundur të jetë kryerës i veprës për të cilën akuzohet.

Gjykata pas analizës dhe vlerësimit të gjitha provave së bashku dhe të secilës veç e veç, nuk gjeti prova që provojnë se veprimet e të akuzuarit A. S. përmbajnë elemente të veprës penale Vjedhje nga neni 325 par.1 të KPRK-së, meqenëse sipas bindjes së kësaj gjykate nuk u vërtetua se i akuzuari e ka kryer veprën për të cilën akuzohet, prandaj e liroi nga akuza në mungesë të provave e në bazë të nenit 364 par.1 pika 1.3 të KPPRK-së.

Gjykata duke u bazuar ne nenin 258 par.2 pika 2.3 te KPPRK-së, mori vendim që të ndaloj marrjen e provës përkatësisht dëgjimit të dëmtuarit-dëshmitarit G. V., ngase sigurimi i prezencës se këtij dëshmitari në gjykate për te dëshmuar është dukshëm i vështirësuar ose i pa arritshëm ngase në bazë të raportit policor i njëjti gjendet jashtë vendit, andaj mbi këtë bazë gjykata ndaloj marrjen e provës dëgjimit të dëshmisë së tij në këtë çështje penale.

Ne bazë të nenit 454 par.1 te KPPRK-së, është vendosur që shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore juridike u mor në kuptim të nenit 463 par.3 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e në kuptim të nenit 364 par.1 pika 1.3 të KPPRK-së.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA NË PODUJEVË
P.nr.455/2014 më datë 12.01.2015

Gjyqtari:
Minir Hoti

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, prej ditës së pranimit të njëjtit. Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.